

Përshëndetje i nderuari z. Ardian Ahmeti,

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të “Reagim dhe kundërshtim”, të paraqitur në procedurën e qëndrimit të “Njoftim Publik”, dt. 26.12.2019 deri me 09.01.2020, të vendosur në bazë të kërkesës 05 Nr. 350/03-267514/19 dt. 31.10.2019, në emër të investitorit NTN “Labi Com” shpk dhe pronarëve, për plotësimin dhe ndryshimin e kushteve ndërtimore të caktuara nga kjo drejtori, me aktin administrativ “Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore”, 05 Nr. 350/02-0144544/18 d. 07.12.2018, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor–projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa banesore dhe afariste në kuadër të bllokut urban “T4”, të të Planit rregullues “Tophane”, në kuadër të parcelave kadastrale nr. 4284-0, 4285-0, 4286-0, 4287-0, 4288-0, 4289-0, 4290-0, 4291-0, 4292-0, 4293-0, 4294-1, 4294-2, 4295-0, 4296-0, 4297-0, dhe pjesëve të parcelave kadastrale nr. 4306-0 dhe 4307-0, ZK Prishtinë, me trajtim me këmbim edhe të parcelës kadastrale nr. 7704-0 ZK Prishtinë, duke ju referuar komenteve dhe shqetësimeve tuaja, ju informon se kjo kërkesë është në procedurë të shqyrtimit dhe të vendosjes, dhe për të njëjtën do të nxirret vendimi përkatës, përkatësisht vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e kushteve ndërtimore, pas plotësimit të të gjitha kriterëve, konform rregullativës ligjore dhe në harmoni me dokumentet e planifikimit hapësinor në fuqi.

Lidhur me ndërtimin e komplekseve me ndërtesa shumëbanesore dhe afariste, të realizuara në lagjen tuaj, kjo drejtori ju informon se çdo leje ndërtimore është lëshuar në harmoni me të gjitha kriteret dhe parametrat urban të përcaktuar me dokumentat e planifikimit hapësinor-Planin Rregullues “Tophane” dhe PZHU, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, dhe konform rregullativës tjetër ligjore në fuqi.

Ndërsa, ankesat e shprehura ndaj problemeve të infrastrukturës dhe kriterëve dhe parametrave të caktuar me dokumentet e planifikimit hapësinor, duhet ti drejtoni te Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, si organ kompetent për hartimin e tyre.

Me respekt,

Nazife Krasniqi

Zyrtare e Lartë për Planifikim dhe Zhvillim

Drejtoria e Urbanizmit

Komuna e Prishtinës

Tel: +383/44 200 528

E-mail: nazife.i.krasniqi@rks-gov.net